

PERSONAZHI | FAKTE

Nga Pjetër Logoreci

Në vazhdim të shkrimit tim për Imzot Nikollë Kaçorri në suplementin Rilindasi të datës 17 Qeshor 2012, po sjell disa ndodhi e fakte të reja nga jeta e atdhetarit Dom Nikollë Kaçorri, të mbe-tuna deri tashti në ertesinë. Së pari due me perforcue fjalët e autorese Maria Amelie Frein von Godin e cila ne librin e saj: Aus dem neuen Albanien të vjetit 1914, (dokumenti 1) tue përshkrue atmosferën e ditëve të shpalljes së pamvarisë së Shqipnisë, të cilen e perretjot vetë, përshkruen personalitetin e Imzot Nikolle Kaçorrit me kto fjalë: Don Nikollë Kaçorri, i cili në nji farë mase ndan me Ismail Kemal Bey-n, presidencën e qeverisë së parë shqiptare, ka mbarue në Shkodër mësimet e para ndër Jesuitët. I mendshëm, i arsimuem, i shkathët, i dashtun e largpamës, ka punue ky burrë në u lodhun për Shqipni, gjithshka muejti dhe unë besoj, që Atdheu i qendron ma afër zemrës së tij se kisha, prelat i të ciles ai asht.....


Pra, mendoj se asht shumë e randësishme që këtë personalitet mos ta shohim vetëm si figurën, e nji prifti katolik, por në nji vështrim ma të gjanë e ma real: si nje punëtor të palodhun e patriot, intelektual lirdashës, si burrë trim e të papërkulun në çdo situatë qi i asht krijuë, tuj u përleshë me forcë me zaptijet e Turkisë me mbrojtë nderin e vet e të shqiptarit", si mësuës e reformues i gjuhës tonë shqipe, si poet e mblledhës folklorit, e si organizator e udhëheqës i paepun i kryengritjeve të malsorve të Krujës për vite me radhë.....

Në librin monografik të zotni Hajredin Isufit "Feja dhe Flamuri: Dom Nikollë Kaçorri", në kreun 6-të, ndarjen IV - Apelimi (faqe 210), autori shkruen: "Për qëndrimin e Kaçorrit në rezidencë nuk kemi të dhëna. Po ashtu nuk dimë nëse u bënë përpjekje të tjera për lirim e tij nga atdhetarët, apo ndoshta nga Vjena. Kemi vetëm lajmin e lirimt, mbas 10 muajsh burgimi." Për periudhën e burgimit të tij, në burgun e Durrësit si edhe të izolimit të tij (arrest shtëpie) në "Konak", në qelën e kishës, flasin disa dokumenta që i gjeta në Arkivin e ministrisë së jashtme austriake të periudhës së denimit të Kaçorrit. Dokumentat bajnë fjalë për përpjekjet e diplomacisë austriake që në kuadrin e Kultusprotektoratit në Shqipni, baheshin për të "zbutun" dënimin e patriotit klerik, për të ba rishikimin e vendimit, që autoritetet vendore turke të lejonin që Imzot Kaçorri të kryente dënimin e mbetun në ambientet e ipeshkvisë së Durrësit.


Në një letër (dokumenti 2)



Dokumenti 1



Dokumenti 2




Dokumenti 3

DOM NIKOLLA KAÇORRI

Dokumentat e reja në arkivin e Vjenës

Atdhetari në altarin e baballarve të kombit. Disa ndodhi e fakte të reja nga jeta e atdhetarit Dom Nikollë Kaçorri, të mbetuna deri tashti në ertesinë



që Imzot Prenk Bardhi, arqipeshkvi i Durrësit, me 29 nandor 1910, i dergon Konsullatës Austriake në Durrës, Konsullit Alfred Rappaport si dhe ministrisë së jashtme të Austrisë, mbasi i tregon për biseden me prokurorin e shtetit Mydei dhe komandantin e bimbashëve Haki Bey në Durrës, për ti mundësue Imzot Kaçorri nji qeli ma të pranueshme se ajo ku ishte në burgun e qytetit, kerkon ndihmën e diplomatëve austriake në kuadrin e Kultusprotektorat për të lejuë ardhjen e Kaçorrit në dhomat e arqipeshkvisë. Këtu po sjellë telegramin (dokumenti 3) që Konsulli Zambaur nga Shkodra, me 3 korrik 1910 i dergon Vjenës dhe Romës, për ndërhyrjet e tij tek Valiu i Shkodrës, i cili i ka dhanë fjalën që çështja Kaçorri të mos shihet me aq ashpërsi dhe të delegohet në Konstantinopol ku do të ketë mundësinë e uljes së dënimt.

Dokumenti tjetër (dokumenti 4) mbanë datën Shkodër, me 22 Korrik 1911. Konsulli von Zambour i dergon

(Lart) Dokumenti 4 (poshtë) Dokumenti 5

Vjenës informacionin e ndërhymsjes së tij pranë Valiut të Shkodrës për të ba lirimin e Imzot Kaçorrit me amnesti.

Mbas transferimit të Imzot Nikollë Kaçorrit nga qelitë burgut të qytetit, për të vazhdue dënimin në dhomat famullisë tij, vjen nji peritudo shumë e veshtirë ekonomike si për të burgosunin ashtu edhe për Imzot Prenkë Bardhin i cili, në staturin që kishte Kaçorri si i denuem



Autori i shkrimit Pjetër Logoreci, ditën e nxjerrjes së eshtrave të Dom Nikollë Kaçorrit në varrezat qëndrore të Vjenës

nuk mund të pretendonte të merrte minde shpërblimi të rrogës për të.

Me një letër - kërkesë (dokumenti 5) Imzot Bardhi i drejtohet autoriteteve të Austrisë që të mundësojnë ndihmë ekonomike për të burgosunin Kaçorri për të gjithë periudhën e dënimt deri sa ai të rifillojë

të punojë në liri. Letra asht në gjuhën italiane i drejtohet nënkonsullit austriak Rudnay dhe mban datën, Durazzo me 8 Tetor 1910:

"Kanë kalue tashma 3 muej e gysë, qyshse famullitari i Durrësit asht pranque padrejtësisht nga gjykata lokale, e nga ajo ditë deri më sot, jashtë forcave të mia ekonomike asht mbajte nga xhepi im i vobektë. Tue marrë në konsideratë mundësitë e mia ekonomike si dhe ato të famullitarit, i cili bile ka edhe ndonji borg, më lejoni që me ardhjen e koncensionit të aprouem nga ministria për famullitarin e ri qi do vijnë, të kërkjo edhe dërgimin ditor të 3 Koronave për mbajtjen e famullitarit (ushqim, pije, cingare, ngrohje) të burgosun deri në lirimin e tij."

Telegrami i datës 19 Janar 1911, (dokumenti 6) që Konsulli i Durrësit Halla i dergon ministrisë së jashtme të Austrisë, mbas kërkesës së Imzot Bardhit flet për akordimin e ndihmës ekonomike Imzot Nikollë Kaçorrit. Menjëherë arqipeshkvisë së Durrësit, Imzot Bardhit, ju aprovue kjo ndihmë e cila i asht dhanë rregullisht për të ndihmue në plotisimin e nevojave të përditëshme jetësore të Dom Nikollë Kaçorrit.

Në këtë dosje në arkiv gjinden të



Dokumenti 6

Dokumenti 7

Dokumenti 8

Dokumenti 9

gjitha Quietanzat – vertëtimet e marrjes së shumave të firmosuna nga Imzot Bardhi, Dom Frano Gjini e Imzot Nikollë Kaçorri. Ka edhe një kërkesë tjetër të Konsullit Halla të datës 30 Korrik 1911, për zgjatjen e ndihmës deri sa Imzot Kaçorri të fillojë përsëri punën e tij baritore, mbas dënimit, ndihmë që edhe kjo ju aprovue nga ministria e jashtme e Austrisë. Këtu po vendos disa nga Quietanzat – vertëtimet (dokumenti 7, 8, 9) për shumat e marrura në ndihmë të Imzot Kaçorrit, si dhe një letër falënderimi (dokumenti 10) të cilën Imzot Nikollë Kaçorri ja dërgon nga Durrësi ministrisë së jashtme të Austrisë me datën 14 Janar 1911.

Kola, që shërben për besimtarët katolikë të Kosovës në Vjenë, që munda të identifikojë varrin e Dom Nikollë Kaçorrit... Përpjekjet e priftit kosovar në Vjenë nuk qenë të lehta. Atij iu desh të kërkojë me ngulm për tre vjet radhazi në dokumentet e Bashkisë së kryeqytetit austriak së bashku me të afërmit e tij. Për mue si pjestar aktiv i këtij komuniteti në Vjenë, e që jam marrë direkt me nxjerrjen dhe riatdhësimin e eshtave të atdhetarit Kaçorri, faktet janë krejt ndryshe. Së pari: Cdo njeri (edhe z.Majko) mundet që nga tryeza e tij e punës, të gjejë varrin e cdo personit të dashtun i

cili asht varrosun në varrezat e Vjenës nëpërmes faqes zyrtare të administratës së varrezave. Mjafton vetëm emri, mbiemri, apo data e lindes / varrimit për të identifikue me saktësi cdo varr qysh nga vitet e luftës së parë botnore, si në rastin e Imzot Kaçorrit. Së dyti: Don Pren Kola nuk asht prifti i besimtarëve katolike kosovarë në Vjenë, por i cdo shqiptarit katolik, pa kufij... Së treti: një ish komunist si z. Majko, nuk mund të bajë apunën e pendimit me një artikull të shkruem mbi Nikollë Kaçorrin, mbas cka ka ndodhë me klerin nga demonët komunistë edhe pse ai i përket një

brezi tjetër. Ai nuk mund të ankoher për lanien në harrësë të Kaçorrit, kur vete Majko ishte në krye të shtetit shqiptar dhe mund ta riatdhësonte arkitektin e pamvarsisë. As Majko e as klerikët shqiptar që sot janë në majet e hierarkisë së kishës katolike shqiptare, që punuen në diasporë (përfshirë ktu edhe Don Pren Kolën) nuk u kujtuen për 94 vjet për ta riatdhesue ktë Liberator edhe pse i kishin mundësitë ekonomike të shpenzojnë 2.600* (të gjithë shpenzimet e nxjerrjes e të ekstradimit të eshtave) për këtë akt. Por ishte kambëngulja e ime, e mbështetun financiarisht nga aus-

triaku Dr. Bernhardt Stillfried që bane të mujtun që Imzot Nikollë Kaçorri të prehet në kishën ku punoj e jetoj. Kushdo mundet për këtë, me pasë informacionet e sakta nga dosja me dokumentet origjinale të ekstradimit të Imzot Kaçorrit të cilat ja kam dhurue bashkë me fotot dhe një film nga dita e nxjerrjes, bibliotekës franceskane në Shkodër.


P.S. Dokumentat e perdorun ne kte shkrim jane gjeje ne Arkiven e Shtetit ne Vjene, PA, Albanien. Eten, me 19 gusht 2012

Tuj shpresue që kam ndriçue ndopak këtë periudhë të padokumentueme të jetës së Titanit Liberator Nikollë Kaçorri, dishroj me tregue edhe një pasazh për këtë personalitet madhor nga Baronsha von Godin në librin e saj Aus dem neuen Albanien (dokumenti 11):

...është Don Kaçorri një burrë i patundun dhe i pandryshueshëm në ndershmërinë që reflekton, e që me forcë e guxim zyrtarisht e përfaqëson. Vetëm ai ka karakterin e fortë të kundërshtojë Ismail Qemalin, i cili dhe pranon mendimet dhe idetë e tij, atij që në qeverinë e parë provizore është përfaqësuesi i denjë i drejtësisë... unë jam e bindun që ky burrë, i cili megjithëse në fushën e besimit asht shumë konsekuent, asht një karakter shumë tolerant, sepse për ndryshe në Shqipni nuk do të kishite një përparim të prishshëm në fushat e tjera, megjithë optimizmin e tij, ai din të jetë realist që të shohë gjanet e përditëshme me kambë në tokë e të mos ike nga realiteti.

Edhe atdhetari Hilë Mosi, nga mergimi, j'a kushton kto vargje (dokumenti 12) në nderim për atdhetarizmin e përkushtimin, Imzot Nikollë Kaçorrit në librin e tij me vjersha Zani Atdheut në 1910-ten.

Së fundit për sqarim të disa gabimeve në shkrimin: Dom Nikollë Kaçorri, ky njeri i jashtëzakonshëm i lënë në harrësë, në gazetën Tema të 3 korrikut 2012, ku z. Pandeli Majko shkruen: "Ishte prifti kosovar Dom Pren



Dokumenti 11



Dokumenti 12